

Annual Report
Insurance Institute. INSIG S.C.

2013



INSIG

Raporti Vjetor

2013



Instituti me kapitalin
më të madh

Shqipëri

“Rruga e Dibrës”, nr.91,
Tiranë
Tel.: +355 4 2 234 191
Fax: +355 4 2 223 838

Kosovë

“Rruga Pashko Vasa”,
nr.4, Prishtinë
Tel.: +381 38 549 904
Fax: +381 38 549 904

Maqedoni

Ul. “Dame Gruev”, nr.5-8/8,
Shkup
Tel.: +389 2321 5515
Fax.: +389 2321 5515

www.insig.com.al

Përmbajtja

Treguesit Kryesorë	6	
Tregu Shqiptar i Sigurimeve	7	
Paraqitja e INSIG sh.a.	9	
Letër e Drejtorit Të Përgjithshëm	10	
Pronësia mbi Kompaninë	12	
Keshilli Mbiikëqyres	12	
Organizimi i Kompanisë	12	
Organigrama e INSIG sh.a.	13	
Rrjeti i Shpërndarjes së Insig sh.a.	14	
Aktiviteti Sigurues	16	
Dëmet nga Veprimtaria Siguruese	18	
Investimet Financiare	19	
Bilanci i Konsoliduar	20	
Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	21	
Raporti i Audituesit të Pavarur	37	

TREGUESIT KRYESORË

Treguesit kryesorë (në mijë lekë)

Prime të shkruara bruto	1,889,393
Prime të shkruara neto	1,604,036
Fitimi neto	218,191 *
Rezervat teknike neto	1,650,448
Rezervat teknike bruto	1,799,698
Raporti i humbjeve (%)	25.1
Raporti i kombinuar (%)	92.5
Zotërimet e aksionerëve	2,347,048

	31 Dhjetor 2012		31 Dhjetor 2011	
	Mesatarja	Mbyll	Mesatarja	Mbyllje
Njësia monetare e EU (Euro)	139.01	139.59	140.33	138.77
Dollari Amerikan (USD)	108.23	105.85	100.89	104.00
Dinari Maqedonas (MKD)	2.259	2.270	2.280	2.256

*) Ketu jane futur vlerat e Insig Shqiperi dhe Maqedoni

VËSHTRIM MBI EKONOMINË SHQIPTARË*

MJEDISI EKONOMIK

Ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje pozitive prej 1.6% në terma realë gjatë vitit 2012. Kjo ecuri është ndikuar nga pasqyrimi më i plotë i stimulit monetar dhe nga përmirësimi i mjedisit të jashtëm ekonomik e financiar. Aktiviteti ekonomik mbetet nën nivelin potencial pavarësisht rritjes së prodhimit. Ky i fundit nuk është shoqëruar me një ulje të pasigurive të përgjithshme, duke ndikuar konsumin dhe investimet private, e për rrjedhojë edhe kërkesën e ofertën për kredi. Rrjedhimisht, kërkesa për kredi vlerësohet të jetë e dobët dhe e kushtëzuar nga ecuria e aktivitetit ekonomik me ritme më të ngadalta, nga pasiguria që vërehet në projeksionet për të ardhmen, si dhe nga sjellja e kujdesshme e sistemit bankar në drejtim të kredidhënies. Norma mesatare vjetore e inflacionit ishte në nivelin prej 2%. Presionet inflacioniste kanë qenë të ulëta duke bërë që inflacioni të jetë

brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2012, duke reflektuar edhe politikën e kujdesshme monetare. Banka e Shqipërisë gjatë këtij viti e ka ndryshuar tre herë normën bazë të interesit duke e çuar atë në 4%. Uljet e njëpasnjëshme të normës bazë të interesit ndihmojnë në uljen e mëtejshme të normave afatshkurtra të interesit në tregjet financiare, duke nxitur aktivitetin dhe duke ulur primet e tregtimit të likuiditetit në to. Nëpërmjet reduktimit të kostove të financimit të sistemit bankar, autoriteti monetar synon uljen e interesave të kredive dhe rritjen e konsumit dhe të investimeve në ekonomi. Sistemi bankar regjistron bilance të shëndosha dhe likuide dhe pozita të mira kapitalizuese, por vijon të karakterizohet nga një kujdes i rritur në financimin e investimeve. Vëllimi i aktivitetit u zgjerua me ritme më të ulëta, në kushtet e rritjes më të ngadaltë të depozitave dhe uljes së ndjeshme të ritmeve të kreditimit. Për sektorin bankar, rreziku i kreditit përfaqëson sfidën më të rëndësishme të veprimtarisë, ndërsa ekspozimi i sistemit ndaj rreziqeve të tregut dhe të likuiditetit mbetet i moderuar.

*Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë për vitin 2012

TREGU SHQIPTAR I SIGURIMEVE*

Tregu i sigurimeve në fund të vitit 2012 ka qenë i mirëkapitalizuar, gjë që ilustron nga treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit mbi nivelin minimal të kërkuar në masën 124.83% (Jo-Jeta), duke bërë të mundur përballimin e një viti relativisht të vështirë e me luhate të rezultateve teknike. Treguesit e Rentabilitetit RoE dhe RoA janë rritur gjatë këtij viti si rezultat i përmirësimit të ndjeshëm së rezultatit financiar neto të kësaj periudhe. Treguesi i aktiveve në mbulim të përgjegjësi ndaj policëmbajtësve për aktivitetin e Jetës dhe të Jo-Jetës janë përkatësisht në masën 110.52% dhe 98.32% për vitin 2012. Aftësia paguese e tregut është 6.16 miliardë lekë në vitin 2012. Raporti i aftësisë paguese është në nivele të larta, rreth 426.48% në nivel tregu. Gjatë vitit 2012, aktivet e tregut të sigurimeve krahasuar me vitin 2011 u rritën me 1.33 miliardë lekë ose 6.98%. Në fund të vitit 2012, kapitalet e veta të tregut arritën në 10.00 miliardë lekë. Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve për vitin 2012, shënoi fitim në vlerën 589 milion lekë, vlerë kjo 870 milion lekë më e lartë se ajo e vitit 2011. Tregu i sigurimeve të Jetës vijon të shënojë rezultate teknike pozitive, përkatësisht në vlerën 214 milion lekë, ndërsa ai i Jo-Jetës ka shënuar rezultat teknik pozitiv në vlerën 25 milion lekë për vitin 2012. Niveli ende i ulët i raportit të primeve të shkruara bruto ndaj PBB në masën 0.66%, vazhdon të përforcojë pritshmëritë, se tregu shqiptar i sigurimeve paraqet potencial të madh për zhvillim të mëtejshëm.

Gjatë vitit 2012 kanë vazhduar të përdoren treguesit e paralajmërimit të hershëm, të rekomanduara nga Banka Botërore për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës në Shqipëri.

Këto tregues financiarë i shërbejnë evidentimit në kohën e duhur të problemeve që mund të çojnë në përkeqësimin e një ose disa parametrave të operatorëve në treg. Ruajtja e qëndrueshmërisë së tregut financiar jo-bankar dhe mbrojtja e konsumatorit janë ndër objektivat kryesore të veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Veprimet e Autoritetit me qëllim parandalimin dhe eliminimin e shkeljeve në këtë drejtim përfshijnë monitorimin e praktikave të tregut në mënyrë të vazhdueshme dhe ndërhyrjen me theks të veçantë në ato zona të cilat janë të ekspozuara ndaj rrezikut të lartë apo në drejtim të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Gjatë vitit 2012, rekomandimet që AMF ka dhënë lidhen kryesisht me:

- Administrimin e rrezikut nga shoqëritë e sigurimit;
- Vlerësimin dhe trajtimin e dëmeve në proces gjyqësor;
- Raportimin në Autoritet të informacionit të kërkuar sipas kërkesave ligjore në fuqi;
- Vlerësimin e përgjegjësisë të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm të shoqërisë lidhur me efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, rregullave të funksionimit dhe të ushtrimit të kontrollit të brendshëm si edhe të cilësisë së raporteve të kontrollit të brendshëm;
- Përmirësimin e politikave, procedurave dhe standardeve teknologjike që lidhen me sigurinë e sistemeve të informacionit.

*Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare – Shqipëri



PARAQITJA e INSIG

Gjatë vitit 2012, INSIG sh.a. kreu aktivitet sigurues në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Më 31 Dhjetor 2012, INSIG sh.a. kishte 128 punonjës të punësuar në këto tre vende.

INSIG veproi si kompani kompozite në Shqipëri, duke kryer në të njëjtën kohë sigurime të jo-jetës dhe sigurime të jetës. Sigurimet e jo-jetës në Kosovë u kryen nga Dega INSIG Kosovë, ndërsa në Maqedoni nga kompania bijë INSIG Makedonija.

Sigurimet e jo-jetës në të tre vendet u përfaqësuan nga produkte të ndryshme, që mbulojnë përgjegjësinë e mbajtësve të mjeteve motorike kundrejt palëve të treta, kasko, zjarrin dhe rreziqet shtesë, vjedhjen, sigurimet e bankave, tipe të ndryshme të përgjegjësisë, marinën dhe mallrat në transport, bujqësinë dhe blegtorinë, etj.

Sigurimet e jetës të ofruara nga Kompania konsistojnë kryesisht në produkte afatshkurtra, si sigurimi i jetës individuale dhe në grup, sigurimi i jetës së nxënësit dhe studentit, sigurimi i jetës së debitorit, sigurimi i kombinuar i jetës. Gjatë vitit 2012 nga Kompania është ofruar produkti i ri i Sigurimit të Jetës dhe Shendetit i cili është një kombinim i sigurimit të shendetit dhe sigurimit afatshkurter të jetës. Ky produkt ju ofron të siguruarve perfitime për trajtimet shëndetsore në klinikat me të mira të vendit dhe të huaja, dhe është i pari produkt i cili ofrohet për grupe dhe individë, si dhe për familje. Pjesën më të madhe të të ardhurave në produktet e sigurimit të jetës e zënë të ardhurat nga Sigurimi i Jetës së Debitorit dhe Sigurimi i jetës në Grup me Aksidente Personale.

Gjatë vitit 2012, INSIG-u ruajti marrëdhënie të qëndrueshme të biznesit me lojtarë të rëndësishëm të tregjeve ndërkombëtare të sigurimeve dhe risigurimeve. INSIG-u cedi një pjesë të rreziqeve tek risiguruesit ndërkombëtarë, duke u bazuar në ligjet përkatëse në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në deklaratën e politikës së veprimtarisë.

Në 21 vjet veprimtari, INSIG-u ka përmirësuar ndjeshëm cilësinë e stafit, nëpërmjet politikave të pranimit dhe programeve të vazhdueshme të trajnimit.

LETËR E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar Aksionar,
Të nderuar Klientë dhe Partnerë,

Ndjehem i nderuar që më është dhënë besimi nga Këshilli Mbikëqyrës i INSIG sh.a. për të qënë Drejtor i Përgjithshëm i një kompanie të tillë të madhe në treg dhe e para e krijuar në të.

Megjithëse pak muaj në drejtim gjatë vitit 2012, do të dëshëroja të theksoja bashkëpunimin e ngushtë me kolegët e mi, partnerët dhe klientët tanë, të cilët më dhanë mbështetjen në ruajtjen e stabilitetit financiar të kompanisë, si dhe duke forcuar optimizmin tim në garantimin e të ardhmes në rritje të saj.

Ne shprehim admirimin e punës që nga koha e krijimit të saj si e para kompani sigurimesh në Shqipëri, në vendosjen e standarteve të reja për ngritjen e performancës dhe forcimin e integritetit të saj në treg. Krijimi i kësaj kompanie, i vlerave dhe kulturës që demonstron ajo qëndrojnë në themel të punës sonë.

Ndërtuar mbi këtë themel, qëllimi ynë është që të bindim klientët tanë se ne jemi vërtet kompania më e sigurt në treg dhe se e ardhmja do të jetë e konsoliduar duke ofruar një shërbim cilësor, kompetitiv dhe bashkëkohor.

Duke marrë në konsideratë këto qëllime, mesazhi ynë për investitorët është se, për të ecur përpara, ne do të përqëndrohemi pikërisht në atë çfarë ne kemi bërë dhe do të bëjmë për të rritur rezultatet tona. Gjatë raportimit për vitin 2013, si vit i parë nën drejtimin si Drejtor i Përgjithshëm, do të ndaj me Ju përmbushjen e këtyre angazhimeve.

Shërbimi ndaj Klientit. Shërbimi përcakton dhe garanton ecurinë e biznesit tonë. Nëse ne do të përqëndrojmë biznesin tonë në funksion të përmbushjes së intereseve të klientëve tanë, atëherë edhe rezultatet do të jenë të dukshme.

Risia. Nuk ka shpërblim më të madh për biznesin tonë sjellja apo adaptimi i risive më të mira për llogari të klientëve tanë. Në këtë drejtim nuk ekziston ndonjë ndryshim apo dallim i dukshëm me subjektet e tjera, megjithëse të dhënat dhe analizat janë të ndryshme.

E ardhmja globale. Klientët tanë veprojnë në tregun global, duke kërkuar nga ne një të ardhme të sigurt për ta dhe INSIG është një kompani e tillë, por që synon zgjerimin e aktivitetit sigurues edhe në rajon.

Profesionalizmi dhe puna në grup. Krijimi i një vizioni të tillë për kompaninë tonë, si një kompani me një histori lideri në tregun shqiptar të sigurimeve dhe përfitimeve që kanë ardhur nga kjo, fillon me cilësinë e profesionalizmit dhe përfundon me harmoninë e punës në grup si ekip i plotë. Gjykimi duhet të bazohet në stafin

profesionist që kemi rekrutuar, në mënyrën e trajtimit dhe trajnimit të tyre, si dhe përmbushjen e standarteve që kërkojmë ndaj njëri-tjetrit. Cilësia e performancës. Kompanitë e tjera ndaj të cilave ne gjykojmë apo krahasojmë arrijtjet tona, i kanë realizuar ato përmes rritjes së cilësisë së performancës. Ata bëjnë pak gabime dhe ato që i konstatojnë i ndreqin shumë shpejt. INSIG aspiron për të vepruar në të njëjtën mënyrë: punë të organizuar, përmirësim të efektivitetit dhe duke bërë biznesin në mënyrën e duhur.

Vlerat. Integriteti me të cilat ne punojmë me të gjithë aktorët tanë dhe me njëri-tjetrin, ka një korrelacion të drejtpërdrejtë në suksesin tonë të qëndrueshëm si kompani.

Së fundi, qëllimi ynë. i cili konsiston në garantimin e qëndrueshmërisë mbi të cilën do të ndërtohet ngritja e mëtejshme e kompanisë. Kjo qëndrueshmëri është ajo që me të vërtetë e bën INSIG të besueshëm dhe konkurrues.

Ne e dimë se kemi shumë për të bërë. Përqëndrimi dhe përkushtimi ynë për këto çështje më sipër do të sigurojnë se pasojat e kësaj kompanie të shquar që nga ditët tona më të hershme të krijimit si kompania e parë në tregun shqiptar të sigurimeve e në vazhdim do të jetë prelude për suksese edhe më të mëdha në të ardhmen.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë klientët dhe partnerët për besimin dhe partneritetin me ne.

Përfundimisht, në emër të kompanisë do të dëshiroja të falenderoj ata të cilët kanë garantuar këtë stabilitet të saj, pikërisht stafin punonjës për punën dhe përkushtimin e tyre. Shpreh besimin se përpjekjet tona do ta çojnë INSIG drejt konsolidimit dhe suksesit.

Tomor Kalaja
Drejtor i Përgjithshëm



PRONESIA MBI KOMPANINE.

Ne perputhje me Statutin e kompanise, neni 6, kapitali themeltar eshte 1.020.000.000 (nje miliard e njezete milione) leke, i ndare ne 1 700 (njemijeshtateqind) aksione, me vlere nominale 600.000 (gjashteqindmije) leke secili. Aksionet e shoqerise zoterohen ne masen 100 % (njqind perqind) nga Republika e Shqiperise, e perfaqesuar nga Ministri i Financave dhe ne bazë të Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit "Shoqëri Anonime SH.A." të datës 09-06-2009 për shoqërinë INSIG sh.a. lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit është deklaruar kalimi i pronesise se 39 % te aksioneve nga BERZH-i dhe KFN-ja tek Ministria e Financave.

KESHILLI MBIKEQYRES

Alfred Rrushaj – Kryetar

Palok Kolnikaj - Zv/Kryetar

Lindita Rusmajli – Anetar

Asllan Shera - Anetar


Omer Stringa - Anetar

ORGANIZIMI I KOMPANISË

INSIG SH.A

NR MESATAR I PUNONJESVE TE INSIG SH.A SHQIPËRI/KOSOVË/MAQEDONI

ZYRAT QENDRORE TIRANË	60
DEGËT(SHQIPËRI)	65
DEGA INSIG SH.A KOSOVË	35
MAQEDONI	64
TOTALI	224
31.12.2012	



ORGANOGRAMA E INSIG

